



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 83

Prishtinë, më 17 qershor 2013, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S 2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, Arsim Bajrami, Behar Selimi, Ardian Gjini, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Gëzim Kelmendi, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivković.

Mungoi: Mufera Shinik.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Visar Smajlaj, ekspert, Vlora Nushi – OSRSG/OPA, Armend Shkoza - LVV, Etleva Ikonja - “Kosova Sot”, Drita... - KDI, Blerta Bejtullahu - EUSR/EVO, Sylë Ahmeti - “Kosova Sot”, Lumturie Beka - “Kosova Info”, Fidan Rama – “Tribuna”, Lirim Geci – “Epoka e re”, Fitim Gashi - “Koha Ditore”, B.D – “Telegrafi”, Valdete Osmani-“Top Channel”, Bajram Gecaj dhe B.M - USEP, Shqipe Osmani- “Bota Sot”, Vlora Marmullakaj - EULEX, Artan Canhasi - EULEX, Petrit Hysaj - OSBE, Admije Sadiku – “Lëvizja Fol”, Lumnije Murati - ZPRK, Imba Mulaj dhe Albulen Gashi, praktikant.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare, të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të planit të zbatimit për këtë marrëveshje;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-170, për transplantimin e organeve;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari, propozoi qe pika e tretë, të hiqet nga rendi ditës.

Albulena Haxhiu, tha se ne në Komision edhe javën e kaluar kemi folur për marrëveshjen dhe asnjëherë nuk jemi ndalur tek vlerësimi i kushtetutshmërisë së marrëveshjes, sepse ne shtojcën numër 2, të rregullores së Kuvendit janë përcaktuar përgjegjësit e Komisionit dhe pikërisht për vlerësimin e kushtetutshmërisë. Haxhiu propozoi që fillimisht të diskutohet vlerësimi i kushtetutshmërisë së marrëveshjes pikë për pikë.

Armend Zemaj, duke u ndërlidhur me parafolësen, tha se ne e kemi në rend dite propozimin që e bëri parafolësja.

Arsim Bajrami, tha se vlerësimin e kushtetutshmërisë e bënë Gjykata Kushtetuese, dhe vetëm pasi të miratohet ligji, ai mund të dërgohet për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese.

Kryetari konstatoi se Komisioni u pajtua që pika tretë, të hiqet nga rendi ditës, kurse nuk u përkrah propozimi i deputetes Albulena Haxhiu.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare, të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të planit të zbatimit për këtë marrëveshje;

Kryetari, përsëriti qëndrimin e tij, që plani i zbatimit mos të jetë pjesë e Projektligjit. Ai propozoi edhe amendamentet, nëse Komisioni pajtohet që plani i zbatimit të hiqet.

Behar Selimi, tha se edhe në mbledhjet e kaluara, qëndrimi i tij ka qenë , se edhe nëse mbetet plani zbatimit, nuk ka ndonjë problem, megjithatë, unë, e kam kuptuar planin e zbatimit sipas të drejtës së traktateve, si pjesë e së drejtës ndërkombëtare, meqë plani zbatimit është parafuar nga të gjithë aktorët, për dallim nga marrëveshja që është parafuar vetëm nga pala jonë dhe Bashkimit Evropian. Sidoqoftë, ne mund të japim interpretimin “për” dhe “kundër”, por meqë konsensusi politik, është për marrëveshjen, pa planin e zbatimit, pra në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, pajtohem që plani i zbatimit të hiqet nga Projektligji.

Arsim Bajrami, theksoi se sipas hierarkisë, vetëm ligjet janë të obligueshme dhe janë pjesë e së drejtës pozitive, e jo edhe aktet nënligjore, siç është plani i zbatimit. Ne do të bënim gabim sikur ta pranonim si pjesë të ligjit, sepse sa herë që do të kishte lëvizje nga plani zbatimit, do të duhej ta ndryshonim ligjin. Ai tha se ne na duhen edhe garanci ndërkombëtare se marrëveshja do të zbatohet nga të dy palët.

Ardian Gjini, tha se në dy mbledhjet e kaluara, ne i kemi sqaruar pozicionet tona dhe tani kemi ardhur në një pikë, ku vetëm duhet rikonfirmuar apo votuar. Amendamentet e propozuara qartësisht e ndajnë planin e zbatimit nga marrëveshja. Gjini përkrahu amendamentet e propozuara nga kryetari Komisionit.

Halit Krasniqi, theksoi se e mbështet qëndrimin e Partisë Demokratike dhe natyrisht edhe arsyetimet e dhëna, duke thënë se edhe plani zbatimit do të duhej të kalojë në Kuvend. Futja e planit të zbatimit si pjesë e ligjit do të na mundësonte që të kontrollojmë çdo lëvizje të Qeverisë, jo pse dyshoj në

veprimet e Qeverise sepse edhe ajo është produkt yni, por pse kjo do të na ndihmonte që t'i kemi në monitorim të vazhdueshëm.

Albulena Haxhiu, tha se është fatkeqësi që komisionet e shkelin Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, sepse Komisioni për Legjislacion, e ka përgjegjësi vlerësimin e kushtetutshmërisë. Diskutimet e paraflësve se a duhet të jetë plani i zbatimit, pjesë e marrëveshjes, nuk e zbehin fare thelbin e kësaj çështje, sepse plani i zbatimit rrjedh nga marrëveshja. Problemi është vet marrëveshja, sepse ajo në princip shpërfytyron shtetin dhe na pamundëson të ardhmen. Arsyeja pse unë kam kërkuar të vlerësohet kushtetutshmëria, para se të shkojë në Kuvend, nuk ka qenë e rastësishme, por, pse Komisioni për Legjislacion nuk e ka kryer punën e tij me përgjegjësi. Këtë marrëveshje e ka miratuar Qeveria e Kosovës, më 22 prill 2013, dhe ne mund ta dërgojmë për vlerësim të kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese, sepse ky vendim e ka miratuar marrëveshjen. Në nenin 113, të Kushtetutës, ekziston baza ligjore për dërgimin në Gjykatën Kushtetuese të këtij vendimi.

Ky projektligj që ngërthen në vete dy anekse, është kundërkushtetues, duke filluar nga fondi zhvillimor, krijimi i asociacionit serb, që nënkupton krijimi i strukturës paralele në nivel shtetëror, themelimi i një njësie së veçantë të Gjykatës së Apelit, në veri, që do të trajtojë rastet e vetëm një etniteti, amnistimi i kriminelëve dhe organizimi i zgjedhjeve, jo nga KQZ-ja, por nga OSBE-ja.

Haxhiu përmendi nenet e Kushtetutës që shkelen me këtë marrëveshje; neni 1, paragrafi 1, neni 3, paragrafi 1, neni 2.2, në lidhje me nenin 20, paragrafi 1, neni 24, paragrafi 1, neni 31, paragrafi 1, neni 65, pika 15, neni 102, paragrafi 2, neni 123, paragrafi 1, neni 124, 125, 127 dhe 139.

Ajo po ashtu tha, se ky Projektligj është në kundërshtim me Rezolutën e Kuvendit të miratuar më 18 dhjetor 2012. Po ashtu, edhe procedimi i këtij Projektligji është në kundërshtim me ligjin, për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare sepse Kryeministri Thaçi nuk e ka marrë parasysh rregullativën, përkitazi me ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare. Ajo, në fund tha, që raporti që dërgohet për seancë, të jetë në përputhje me nenin 68.5, të Rregullores, që nënkupton që raporti duhet të përmbajë edhe argumentet shtesë të subjektit që ka votuar kundër.

Haki Demolli, tha se ne kemi mbajtur dy mbledhje, në të cilat kemi identifikuar dy çështje; e para, heqja e planit të zbatimit nga marrëveshja dhe çështja e dytë, përshtatja e çështjeve gjuhësore në tri versionet. Tani për këto dy çështje, kemi gjetur zgjidhjen. E kemi marrë versionin e marrëveshjes që është harmonizuar në tri gjuhët dhe e kemi pajtimin e Grupit Parlamentar të PDK-së, që të hiqet plani i zbatimit. Demolli propozoi që amendamentet e propozuara nga kryetari Komisionit, të hidhen në votim.

Kryetari konstatoi se Komisioni, me 9 vota “për “ dhe 1 votë “ kundër “ (Albulena Haxhiu), vendosi që, Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

1. Të shqyrtohet dhe të miratohet Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare, të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, me amendamentet e propozuara.

Amendamenti 1

Në titullin e projektligjit hiqen fjalët “**DHE TË PLANIT TË ZBATIMIT PËR KËTË MARRËVESHJE** “

Amendamenti 2

Neni 1 i Projektligjit riformulohet si vijon:

Neni 1 Qëllimi

Ky ligj ratifikon Marrëveshjen e Parë Ndërkombëtare, që rregullon normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, parafuar, më 19 prill 2013, nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri i Republikës së Serbisë, miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, më 22 prill 2013, Vendimi Nr. 01/126, dhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 22 prill 2013, Rezoluta Nr. 04-R-10. ”

Amendamenti 3

Neni 2, i Projektligjit riformulohet si vijon:

Neni 2 Fushëveprimi

Fushëveprimi i këtij ligji është Marrëveshja e Parë Ndërkombëtare e Parimeve, që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, dhe është pjesë përbërëse e këtij ligji. Ky ligj do të zbatohet nga Republika e Kosovës, me ndihmën e Bashkimit Evropian, (BE), Forcave të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut në Kosovë, (KFOR), dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

2. Të harmonizohet versioni i marrëveshjes në gjuhën shqipe dhe serbe, me versionin në gjuhën angleze.

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, në Projektligjin nr. 04/L- 170, për transplantimin e organeve;

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, në Projektligjin për transplantimin e organeve, dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen, nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, Kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

P ë r f u n d i m

1. Projektligji nr. 04/L -170, për transplantimin e organeve dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund ti procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

Kryetari i Komisionit

E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit

Arben Gashi